



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 26.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.11.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " Sankos " Sh.p.k. dergoj Kërkesen per Rishqyrtim, lidhur me , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore "- Lot 1: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore për Brigadën e Zjarrëfiksëve" , Nr. i prokurimit- 632-24-9757-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-052-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " Sankos " Sh.p.k., e dt.25.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore "- Lot 1: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore për Brigadën e Zjarrëfiksëve" , Nr. i prokurimit- 632-24-9757-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-052-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 19.11.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 19.11.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik " Sankos " Sh.p.k., me dt.25.11.2024, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore "- Lot 1: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore për Brigadën e Zjarrëfiksëve" , Nr. i prokurimit- 632-24-9757-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-052-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 26.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse kjo ka qenë kërkesë e FDT-së, për çka ju keni nënshkruar deklaratën nën betim se jeni i përgjegjshëm dhe plotësoni kërkesat në FDT-ë. Vlerësimi i ofertave është bërë sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Nëse ju pretendoni se ISO 17050, është Standard për akreditimin e laboratorëve të tekstitit, atëherë ju këtë pikë është dashur ta atakoni para hapjes së tenderit duke kërkuar sqarime shtesë apo duke parashtruar kërkesë për rishqyrtim!

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

